



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

Tiranë, më 28.10.2022

Dokument parlamentar

Komision përgjegjës

R A P O R T

PËR PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E BUXHETIT FAKTIK TË VITIT 2021”

I. Hyrje.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e Komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 28 tetor 2022, shqyrtoi projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2021”.

Projektligji është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat e shqyrton këtë projektligj sipas procedurave të parashikuara në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Komisioni caktoi relatores, për këtë projektligj, znj. Blerina Gjylameti.

Në mbledhjen e Komisionit ishin të ftuar:

Nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë:

- Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre;
- Znj. Mimoza Dhembli, Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit dhe Borxhit Publik;
- Z. Nikolla Lera, Drejtor i Drejtorisë së Përgjithme të Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;
- Znj. Xhoana Agolli, Drejtore e Drejtorisë së Menaxhimit të Buxhetit;
- Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Makroekonomike dhe Çështjeve Fiskale;
- Znj. Mimoza Peço, Drejtore e Drejtorisë së Operacioneve të Thesarit;
- Znj. Kesjana Halili, Drejtore e Drejtorisë së Borxhit Publik;
- Znj. Sjuzi Lazebeu, Këshilltare.

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit:

- Z. Arben Shehu, Kryetar;
- Znj. Mariola Llanaj, Drejtore e Përgjithshme;
- Znj. Valbona Gaxha, Sekretare e Përgjithshme;
- Z. Gjovalin Preçi, Drejtor i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit;
- Z. Qeram Cibaku, Kryeauditues, Departamenti i Auditimit të Institucioneve Qendrore.

II. Baza ligjore.

Shqyrtimi i projektligjit për miratimin e buxhetit faktik të vitit të mëparshëm është një procedurë e konsoliduar ndër vite, e cila mbështetet në:

- nenet 158 dhe 164 të Kushtetutës;
- nenin 63 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
- nenin 31 të ligjit nr.154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ligjin nr.137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar;
- ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar.

Këshilli i Ministrave e ka propozuar projektligjin bazuar në nenet 78 dhe 83, pika 1 të Kushtetutës.

III. Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit.

Qëllimi i projektligjit është miratimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit për vitin 2021. Ky raport përmban informacione, statistika dhe analiza të detajuara mbi pasqyrat e konsoliduara vjetore për transaksionet financiare të shtetit, zbatimin e buxhetit vjetor, borxhin publik dhe përbërjen e tij, përdorimin e fondit rezervë dhe të kontigjencës, si dhe situatën e kontrollit të brendshëm publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Projektligji dhe Raporti i Këshillit të Ministrave shoqërohen me Raportin e Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2021, i cili pasqyron opinionin e këtij institucioni për përputhshmërinë e hartimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit, si dhe funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm në sektorin publik. Raporti i KLSH përmban një analizë të hollësishme të situatës

makroekonomike e fiskale të vitit të mëparshëm, buxhetit vjetor, borxhit publik, si dhe përdorimit të fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Opinionin e KLSH bazohet në gjetjet dhe rekomandimet e auditimeve të kryera nga KLSH në institucionet e qeverisjes qendrore, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë e tjera publike. Në këtë raport KLSH pasqyrohen edhe masat dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes.

IV. Diskutimi në Komision.

Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë, paraqiti projektligjin, duke u ndalur në realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë gjatë vitit 2021.

Z. Arben Shehu, Kryetar i Kontrollit të Lartë të Shtetit, paraqiti raportin e këtij institucioni mbi zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Më pas, përfaqësuesit e këtyre institucioneve iu përgjigjën pyetjeve të deputetëve.

* * *

Relatorja paraqiti opinionin e saj për projektligjin, si dhe për raportet respektive të Këshillit të Ministrave dhe KLSH mbi zbatimin e buxhetit faktik të vitit 2021. Ajo analizoi realizimin e treguesve kryesorë makroekonomikë e fiskalë për vitin 2021, të krahasuar me periudhat e mëparshme.

Relatorja theksoi se gjatë vitit 2021 ekonomia e vendit u ndesh me disa sfida, për përballimin e të cilave Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave zbatuan një sërë masash lehtësuese e nxitëse.

Buxheti i vitit 2021 u ndryshua me 6 akte normative të Këshillit të Ministrave, të cilat kishin qëllim zbutjen e efekteve ekonomike e sociale të tërmetit dhe të pandemisë shëndetësore COVID-19, mbështetjen e sektorit të energjisë elektrike, mbështetjen e shtresave në nevojë, si dhe kryerjen e investimeve në disa sektorë prioritarë të ekonomisë. Ndryshimet specifike të këtyre akteve normative janë si më poshtë:

- *Akti normativ nr.4, datë 5.2.2021*, i cili ruajti të pandryshuar deficitin buxhetor dhe borxhin publik, duke rritur përkatësisht në të njejtën vlerë (3.42 miliardë lekë) të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit. Qëllimi i këtij akti normativ ishte financimi i nevojave shtesë të procesit zgjedhor.
- *Akti normativ nr.8, datë 22.3.2021*, i cili mundësoi një rialokim prej 1 miliardë lekësh brenda zërave të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave. Qëllimi i këtij akti normativ

ishte sigurimi i fondit të nevojshëm për blerjen e vaksinës kundër pandemisë Covid-19. Akti normativ nuk ndryshoi treguesit kryesorë makroekonomikë e fiskalë, të parashikuar në ligjin për buxhetin e vitit 2021: deficitin buxhetor, borxhin publik, të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit.

- *Aktin normativ nr.18, datë 14.4.2021*, i cili mbështeti procesin e vaksinimit, duke rritur me 2 miliardë lekë shpenzimet në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, përmes rritjes me të njëjtën vlerë të të ardhurave tatimore. Ky akt normativ nuk ndryshoi nivelin e deficitit buxhetor dhe borxhit publik, të parashikuar në fillim të vitit.
- *Aktin normativ nr.26, datë 22.6.2021*, i cili rriti shpenzimet e përgjithshme të buxhetit dhe deficitin buxhetor me 11.8 miliardë lekë, duke mos rritur nivelin e të ardhurave të përgjithshme. Rritja e shpenzimeve, si dhe disa rialokime në shpenzimet korrente e kapitale mundësuan financimin e procesit të vaksinimit të popullsisë kundër pandemisë Covid-19, si dhe zbatimin e disa projekteve prioritare në fushën e teknologjisë së informacionit, strehimit social, transportit rrugor, ujësjellës-kanalizimeve, zhvillimit ekonomik, sistemit të drejtësisë etj.
- *Aktin normativ nr.31, datë 27.10.2021*, i cili mundësoi:
 - ✓ *Së pari*, mbështetjen financiare të Shoqërisë OSHEE, sha, për të përballuar rritjen e menjëhershme të çmimeve të energjisë elektrike dhe për të furnizuar në mënyrë të pandërprerë konsumatorët. Kjo mbështetje u sigurua përmes miratimit të garancisë sovrane prej 10 miliardë lekësh për vitin 2021;
 - ✓ *Së dyti*, financimin e nevojave buxhetore, nëpërmjet rritjes së kufirit të huamarrjes neto vjetore të vitit 2021, për të akomoduar daljen me eurobond në tregjet ndërkombëtare me një vlerë më të lartë se ajo e parashikuar fillimisht, pra nga 500 milionë euro, në 700 milionë euro.
- *Akti normativ nr.34, datë 3.12.2021*, i cili rriti respektivisht me 18.2 miliardë lekë të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme të buxhetit për të mundësuar:
 - ✓ Dhënien e shpërblimit të pensionistëve në fund të vitit;
 - ✓ Financimet shtesë për fondin e rindërtimit, mirëmbajtjen e rrugëve, shtresat në nevojë, fermerët, qiratë e strehimit social, investimet në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve, transportit rrugor, godinën e Polit të Drejtësisë, për projektet e zhvillimit, dixhitalizimin dhe qeverisjen elektronike, projektet kundër pandemisë Covid-19, si dhe ndërtimin e disa segmenteve të rëndësishme të infrastrukturës kombëtare;
 - ✓ Financimin shtesë për njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të mundësuar rritjen e investimeve në rrugët rurale, përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura nga disa bashki. Financimet shtesë u

parashikuan të realizohen përmes rritjes së të ardhurave të qeverisjes qendrore e vendore, si dhe rialokimeve buxhetore, pa rritur treguesit e deficitit buxhetor dhe të borxhit publik.

Më tej, relatorja paraqiti disa nga karakteristikat kryesore të situatës ekonomike e buxhetore për vitin 2021, si më poshtë:

1. Rikuperimi i shpejtë i ekonomisë dhe rritja ekonomike mbi parashikimet.

Viti 2021 ishte viti i rikthimit në rritje të ekonomisë së vendit, pas recensionit të thellë të një viti më parë, si pasojë e goditjeve të tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë botërore COVID-19.

Rritja ekonomike ishte 8.5 për qind, duke qenë ndjeshëm mbi parashikimin në fillim të vitit prej 5.5 për qind. Ky ritëm i rritjes, vjen pas një rënie të ekonomisë me -3.5 për qind në vitin 2020. Rritja ekonomike e tejkaloi nivelin e vitit 2019, i cili ishte një vit me ecuri normale të ekonomisë. Në krahasim me vitin 2019, rritja ekonomike në vitin 2021 ishte 4.8 për qind.

Ritmi i rritjes ekonomike ishte i lartë, si rezultat i politikave fiskale e monetare lehtësuese dhe stimuluese, për të mbështetur shtresat e popullsisë më të goditura dhe sektorët prioritarë të ekonomisë.

Ky ritëm i lartë i rritjes ekonomike është ndikuar nga rritja e konsumit privat dhe investimeve. Sipas sektorëve të ekonomisë, kontributin më të madh në rritjen ekonomike e dhanë sektorët e ndërtimit, tregtisë dhe industrisë, ndërkohë që edhe sektorët e tjerë kontribuan pozitivisht.

Edhe Ballkani Perëndimor i përshpejtoi ritmet e rritjes ekonomike gjatë vitit 2021, me një ritëm mesatar të rritjes prej 7.6 për qind, pas tkurrjes me - 3.3 për qind në vitin 2020.

Rritja ekonomike në vendin tonë ishte më e lartë se rritja mesatare ekonomike në Ballkanin Perëndimor. Vendi ynë rezultoi i treti nga niveli i rritjes ekonomike në Ballkanin Perëndimor, duke qenë pas Malit të Zi e Kosovës dhe më lart se Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, si dhe Maqedonia e Veriut.

2. Përmirësimet në tregun e punës.

Ecuria e mirë e aktivitetit ekonomik u shoqërua me përmirësime në tregun e punës. Norma e papunësisë arriti nivelin mesatar vjetor prej 12 për qind, ndërsa në tremujorin e fundit arriti

11.4 për qind, nga 12.2 për qind që ishte një vit më parë. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, shkalla e papunësisë në vendin tonë është ndër më të ulëtat. Shkalla e punësimit arriti 60.9 për qind, nga 60.6 për qind që ishte një vit më parë. Paga mesatare u rrit me 8 për qind në krahasim me një vit më parë.

3. Rikthimi drejt konsolidimit fiskal.

Në vitin 2020 nevojat për hua kanë qenë të larta, për përballimin e vështirësive që sollën dy fatkeqësitë natyrore, tërmeti i vitit 2019 dhe pandemia shëndetësore COVID-19. Kjo bëri që vendi të shmangej përkohësisht nga politika e konsolidimit fiskal. Si rrjedhojë, deficitit buxhetor dhe borxhi publik u rritën ndjeshëm.

Edhe në vitin 2021 nevojat për hua ishin të mëdha, për të vijuar përballimin e efekteve të goditjeve të mëparshme, si dhe për të stimuluar rimëkëmbjen e ekonomisë pas recensionit të vitit të mëparshëm. Me rritjen e ndjeshme të ekonomisë gjatë vitit 2021, vendi u rikthye drejt konsolidimit fiskal, gjë që pasqyrohet nëpërmjet treguesve deficitit buxhetor dhe borxhit publik, si më poshtë:

- *Deficiti buxhetor* u reduktua nga 6.7 për qind e PBB në vitin 2020, në 4.5 për qind të PBB në vitin 2021;
- *Borxhi publik* u reduktua nga 74.5 për qind e PBB në vitin 2020, në 73.2 për qind të PBB në vitin 2021.

Borxhi publik u realizua në përputhje me objektivat e parashikuara në projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm dhe Strategjinë Afatmesme të Menaxhimit të Borxhit.

Në fund të vitit 2021, stoku i borxhit publik arriti nivelin 73.2 për qind e PBB, nga 78.1 i parashikuar në projektbuxhetin vjetor dhe afatmesëm.

Megjithë nevojat e mëdha për financim, huamarrja arriti të plotësojë nevojat buxhetore për vitin 2021, si dhe të gjitha nevojat që burojnë nga detyrimet e borxhit ekzistues.

Huamarrja u favorizua nga:

- Kushtet e favorshme në tregjet e brendshme dhe ndërkombëtare;
- Mjedisi i favorshëm i normave të interesit;

- Strategjia e huamarrjes, e mbështetur kryesisht në titujt afatgjatë dhe me norma interesi fiske.

Këta faktorë ndikuan në reduktimin e ekspozimit të borxhit ndaj risqeve dhe mbajtjen nën kontroll të kostos së borxhit.

Kostoja mesatare e borxhit të brendshëm u reduktua me 0.1 pikë përqindje dhe u ndikua nga:

- Normat e ulëta të interesit në tregun e brendshëm gjatë vitit 2021;
- Rifinancimi i borxhit që maturohej me borxh më pak të kushtueshëm.

Kostoja mesatare e borxhit të jashtëm u reduktua me 0.3 pikë përqindje.

4. Vazhdimi i politikës monetare stimuluese, të harmonizuar me politikën fiskale.

Politika monetare vijoi të mbetet në kahun stimulues, në harmoni me politikën fiskale, duke kontribuar në ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe nxitjen e rimëkëmbjes ekonomike të vendit. Stimuli monetar kontribuoi me rreth 1.3 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2021. Banka e Shqipërisë mbajti normën bazë të interesit në nivelet minimale, duke ndikuar në reduktimin e kostove për financimin e sektorit privat, rritjen e shpejtë dhe të qëndrueshme të kreditimit dhe ruajtjen e një kursi të qëndrueshëm të këmbimit valutor.

Norma mesatare e inflacionit ishte 2 për qind, ndërsa inflacioni në fund të vitit ishte 3.7 për qind. Ndikimin kryesor në rritjen e inflacionit e dhanë rritja e çmimit të ushqimeve dhe transportit. Në krahasim me vendet e tjera të rajonit, norma e inflacionit në vendin tonë ishte ndër më të ulëtat.

Stoku i kredive bankare u rrit me 9.5 për qind në krahasim me vitin 2020, ku peshën kryesore e ka rritja e kredisë për bizneset. Me rritje rezultoi edhe kredia për individët.

Kreditë me probleme u reduktuan me 5.7 për qind në fund të vitit, krahasuar me një vit më parë. Ky reduktim ishte rrjedhojë e masave të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, si dhe e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe gjendjes financiare të kredimarrësve. Kursi i këmbimit ndaj valutave kryesore ka qenë përgjithësisht i stabilizuar.

5. Rritja mbi parashikimet e të ardhurave të përgjithshme të buxhetit.

Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të konsoliduar, për vitin 2021, ishin 510.6 miliardë lekë.

Këto të ardhura:

- Në krahasim me planin, u rritën me 2.8 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 101 për qind;
- Në krahasim me një vit më parë, u rritën me 85 miliardë lekë ose 19.9 pikë përqindje.

Rritja e të ardhurave ishte rezultat i ecurisë pozitive të ekonomisë dhe miradministrimit fiskal. Rigjallërimi i ekonomisë; zhvillimet në sektorin e turizmit, ndërtimit, rindërtimit të pasojave të tërmetit; ndikuan në rritjen e qarkullimit, të importeve, prodhimit të brendshëm dhe të ardhurave të buxhetit.

Politikat fiskale.

Politikat fiskale të vitit 2021 synuan sigurimin e një taksimi të drejtë, të balancuar, që nxit produktivitetin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë.

Gjatë vitit 2021 u miratuan një sërë politikash lehtësuese ndaj biznesit dhe sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, për të zbutur pasojat e tërmetit dhe të pandemisë Covid-19, si dhe për të rritur konkurrueshmërinë e ekonomisë.

Politikat kryesore që u zbatuan gjatë vitit 2021 ishin nxitja dhe lehtësimi i investimeve në infrastrukturën sportive, nëpërmjet vendosjes së shkallës së reduktuar të TVSH-së 6 për qind, rritja nga 2 milionë lekë/vit, në 10 milionë lekë/vit e kufirit minimal të regjistrimit për TVSH etj.

Gjatë vitit 2021 u ndërmorrën edhe disa politika që i filluan efektet nga data 1 janar 2022, siç ishin vendosja e shkallës së reduktuar të TVSH prej 10 për qind për furnizimin e inputeve bujqësore, ndryshimi nga 50 milionë lekë, në 500 milionë lekë i kufirit minimal të regjistrimit për TVSH për makineritë dhe pajisjet sipas kontratave të investimit; rishikimi i skemës së tatimit mbi të ardhurat personale nga punësimi, duke rritur pagën dysheme të patatueshme dhe duke reduktuar normat tatimore etj.

Sipas grupeve kryesore, realizimi i të ardhurave është si më poshtë:

- *Të ardhurat nga tatimet dhe doganat* përbëjnë peshën kryesore, 66 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 102 për qind në krahasim me planin, me një tejkalim prej 5.3 miliardë lekësh. Vërehet rritje nga 65.5 për qind, në 66 për qind e peshës specifike që zenë të ardhurat nga tatimet dhe doganat në të ardhurat e përgjithshme të buxhetit. Rezultati pozitiv në këto të ardhura vjen nga rimëkëmbja e ekonomisë, e reflektuar në rritjen e aktivitetit ekonomik, rritjen e kërkesës së brendshme e të jashtme, rritjen e numrit të të punësuarve dhe, si rrjedhojë, të të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore.
- *Të ardhurat nga fondet speciale* përbëjnë 22 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 103 për qind, me një rritje prej 2.8 miliardë lekësh. Rritja e këtyre të ardhurave ishte rezultat, kryesisht, i rritjes së të ardhurave nga sigurimet shoqërore, për shkak të reformës së pensioneve, si dhe administrimit më të mirë fiskal.
- *Të ardhurat nga pushteti vendor* përbëjnë 5 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 103 për qind, me një tejkalim prej 0.8 miliardë lekësh.
- *Të ardhurat jotatimore* përbëjnë 4 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 103 për qind, me një tejkalim prej 0.7 miliardë lekësh.
- *Të ardhurat nga grantet* përbëjnë 2 për qind të të ardhurave të përgjithshme të buxhetit. Këto të ardhura u realizuan në masën 65 për qind, me një mosrealizim prej 6.7 miliardë lekësh.

6. Realizimi i shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit në përputhje me prioritetet.

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, për vitin 2021, arritën nivelin 596 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 100.5 për qind të planit sipas buxhetit fillestar dhe 95 për qind të planit të

rishikuar. Në krahasim me një vit më parë, këto shpenzime u rritën me 59.5 miliardë lekë ose 11.1 pikë përqindje.

Struktura e shpenzimeve të përgjithshme pësoi ndryshime gjatë vitit, në krahasim me planin fillestar, për të përballuar efektet e pandemisë, procesin e rindërtimit dhe krizën e sektorit energjitik.

Realizimi i shpenzimeve, sipas grupeve kryesore, rezulton si më poshtë:

- *Shpenzimet korrente* përbëjnë 77.4 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime arritën vlerën 461 miliardë lekë, duke u realizuar në masën 96 për qind të planit, me një mosrealizim prej 20 miliardë lekësh. Në krahasim me një vit më parë, këto shpenzime u rritën me 39.7 miliardë lekë ose 9.4 pikë përqindje. Niveli i këtyre shpenzimeve ndaj PBB, në vitin 2021, ishte 26 për qind e PBB, duke qendruar në të njëjtin nivel me vitin 2020. Në vitet e mëparshme niveli mesatar i shpenzimeve korrente ishte 24.4 për qind e PBB.
- *Shpenzimet kapitale* përbëjnë 16 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Këto shpenzime, për vitin 2020, arritën nivelin 98 miliardë lekë, i cili është 105.6 për qind e planit fillestar dhe 88 për qind e planit të rishikuar. Në krahasim me një vit më parë, shpenzimet kapitale u rritën me 13 miliardë lekë ose 15.1 pikë përqindje. Rritja e shpenzimeve kapitale ishte rrjedhojë e ecurisë pozitive të projekteve të investimeve me financim të brendshëm, të cilat u realizuan në masën 90 për qind të planit të rishikuar. Investimet nga të ardhurat e arsimit të lartë u realizuan në masën 89 për qind. Shpenzimet kapitale me financim të huaj u realizuan në masën 82 për qind të planit të rishikuar.

Nëse analizojmë shpenzimet sipas natyrës funksionale, vërejmë se:

- Sektori me peshën më të lartë të shpenzimeve është mbrojtja sociale, e cila përbën 38 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit. Peshën kryesore e përbëjnë shpenzimet për fondin e pensioneve, si dhe programet mbështetëse për familjet dhe individët në nevojë (ndihma ekonomike dhe aftësia e kufizuar).
- Shëndetësia përbën 12 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

- Çështjet ekonomike përbëjnë 12 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.
- Arsimi përbën 9 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.
- Strehimi dhe komoditetet e komunitetit (ku përfshihen infrastruktura rrugore, ujësjellës-kanalizimet, mbetjet urbane dhe planifikimi urban) përbën 8 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.
- Shërbimet e përgjithshme publike (ku përfshihen edhe pagesat e borxhit) përbëjnë 9 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.
- Rendi dhe siguria publike përbëjnë 7 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.
- Mbrojtja përbën 3 për qind të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit.

7. Orientimi i investimeve publike drejt sektorëve prioritarë të ekonomisë.

Shpenzimet kapitale të vitit 2021 kishin prioritet rindërtimin e infrastrukturës së dëmtuar nga tërmeti, kryesisht në fushat e arsimit, infrastrukturës publike dhe strehimit. Gjithashtu, u mbështetën me prioritet sektorët e infrastrukturës së ujësjellës kanalizimeve, transportit rrugor, shëndetësisë, mbrojtjes etj.

Gjatë vitit 2021 u financuan dhe u mbyllën rreth 138 kontrata investimesh me financim të brendshëm, me vlerë të plotë të projekteve prej rreth 31 miliardë lekësh. Këto investime u kryen në fushat e transportit rrugor; ujësjellës-kanalizimeve; menaxhimit të mbetjeve; rikonstruksioneve të qendrave spitalore, poliklinikave e qendrave shëndetësore, sistemit të ujitjes, argjinaturave të lumenjve, sistemeve të mbrojtjes e kompjuterike, mjediseve të punës për SPAK dhe Policinë e Shtetit, shkollave e kopshteve; përmirësimin e mjedisit; përmirësimin

e efijencës së energjisë në impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe furnizimit me ujë, si dhe disa projekte kulturore.

8. Vazhdimi i zbatimit të programit të rindërtimit ishte një ndër prioritetet e buxhetit 2021.

Programi i rindërtimit për përballimin e pasojave të tërmetit të vitit 2019 u zbatua në përputhje me kërkesat ligjore.

Fondi i planifikuar për vitin 2021 për programin e rindërtimit ishte 28 miliardë lekë, i destinuar për të përballuar kostot për projektet e miratuara dhe të pafinancuara për vitin 2020, si dhe për projektet e reja. Të ardhurat nga grantet janë një burim tjetër, të cilat rrisin në të njëjtën masë të ardhurat dhe shpenzimet për fondin e rindërtimit.

Shpenzimet faktike për rindërtimin ishin rreth 39 miliardë lekë, nga të cilat:

- Rreth 10 miliardë lekë ishin fonde të trashëguara nga viti 2020;
- Rreth 29 miliardë lekë ishin fonde të akorduara gjatë vitit 2021.

Këto fonde u përdorën nga:

- Njësitë e qeverisjes qendrore 12 miliardë lekë;
- Njësitë e qeverisjes vendore 27 miliardë lekë.

Përmes këtyre fondeve:

- Fondi Shqiptar i Zhvillimit rindërtoi 1711 objekte arsimore, godina kolektive dhe banesa individuale;
- Agjencitë e tjera qendrore punuan për rindërtimin e urës së Tapizës, plane konservimi, restaurime, rikonstruksione objektsh, si dhe hartimin e disa planeve vendore;
- Rreth 13 mijë familje u akomoduan në apartamente me qira të subvencionuar nga shteti, si dhe u rindërtuan banesa;
- Njësitë e qeverisjes vendore përdorën rreth 64 për qind të fondeve të akorduara.

9. Thellimi i mëtejshëm i decentralizimit fiskal.

Fokusi kryesor i pushtetit vendor, gjatë vitit 2021, ishte vazhdimi i konsolidimit të menaxhimit financiar në nivel vendor, duke synuar thellimin e reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimin fiskal. Disa nga arritjet më të rëndësishme në menaxhimin financiar vendor, gjatë vitit 2021, ishin:

- Rritja e ndjeshme e të ardhurave tatimore të pushtetit vendor.
 - ✓ Në krahasim me vitin e mëparshëm, këto të ardhura u rritën me 4.7 miliardë lekë ose 21.3 pikë përqindje. Pesha specifike që këto të ardhura zenë ndaj të ardhurave të përgjithshme të buxhetit është rritur nga 5.16 në vitin 2020, në 5.22 për qind në vitin 2021.
 - ✓ Në krahasim me planin, këto të ardhura u realizuan në masën 103 për qind, me një tejkalim prej 0.7 miliardë lekësh;
 - ✓ Kontributi i të ardhurave të pushtetit vendor ndaj PBB është rritur nga 0.8 për qind e PBB në vitin 2015, në 1.5 për qind të PBB në vitin 2021. Ky është një tregues pozitiv i zbatimit të reformës administrativo-territoriale, e cila solli rritje të të ardhurave të pushtetit vendor dhe përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve.
- Rritja e mbështetjes nga buxheti qendror për pushtetin vendor, në formën e transfertës së pakushtëzuar dhe sektoriale. Në vitin 2021, krahasuar me një vit më parë, transfertat e pakushtëzuar u rrit me 1.6 miliardë lekë ose 6.2 pikë përqindje.
- Rritja e shpenzimeve të pushtetit vendor, të cilat në vitin 2021 u rritën me 1 miliardë lekë ose 2 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Në krahasim me planin, këto shpenzime u realizuan në masën 90 për qind, me një mosrealizim prej 5.7 miliardë lekësh. Ky mosrealizim ka qenë rrejdhojë e efekteve të pandemisë COVID-19 dhe e procesit të rindërtimit.

Relatorja u ndal edhe në gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga raporti i KLSH. KLSH ka audituar përputhshmërinë e hartimit, miratimit, zbatimit dhe raportimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021.

Opinion i përgjithshëm i auditimit është si më poshtë:

“Me përjashtim të disa situatave të theksuara në Raportet Përfundimtare të Auditimit, procedurat e përgatitjes, miratimit dhe ekzekutimit të Buxhetit të Shtetit zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor dhe dispozitat rregulluese në fuqi. Respektivisht, planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve dhe transfertave, si dhe planifikimi dhe realizimi i të ardhurave dhe të hyrave të

tjera, janë në përputhje me shumat dhe dedikimet e përcaktuara në buxhetet e miratuara të njësive shpenzuese buxhetore.

Raporti i Zbatimit të Buxhetit të Shtetit për vitin 2021 jep informacion të besueshëm për të ardhurat e shtetit, shpenzimet, investimet dhe operacionet financiare.

Gjatë auditimit të ushtruar në disa prej zërave buxhetorë si të ardhurat, shpenzimet, deficitit dhe financimi i tij, si dhe detyrimet kontigjente, ka devijime materiale sasiore dhe cilësore, në drejtim të hartimit, zbatimit dhe raportimit të tij, jo në përputhje me:

- *Ligjin nr. 137/2020 “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar;*
- *Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006, “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;*
- *Ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar;*
- *Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” si dhe*
- *Aktet e tjera nënligjore në zbatim të tyre.”.*

Relatorja theksoi se në Raportin e KLSH, si dhe në fjalën e Kryetarit të KLSH, janë evidentuar disa problematika lidhur me zbatimin e buxhetit të vitit 2021 nga njësitë përdoruese të fondeve publike, janë paraqitur analiza të hollësishme dhe janë dhënë rekomandimet përkatëse.

Bazuar në të gjithë anëlizën e mësipërme, relatorja paraqiti disa rekomandime për përmirësimin e hartimit dhe zbatimit të buxhetit në të ardhmen, si më poshtë:

Së pari, është i nevojshëm përmirësimi i vazhdueshëm i procesit të planifikimit buxhetor afatmesëm dhe atij vjetor, për t’i harmonizuar midis tyre, si dhe për të siguruar saktësi dhe cilësi në zbatimin e prioriteve strategjike të vendit.

Së dyti, prioritet mbetet rritja e të ardhurave buxhetore, nëpërmjet uljes së informalitetit dhe zgjerimit të bazës së tatimpaguesve, si dhe arkëtimit të detyrimeve të prapambetura tatimore e doganore.

Së treti, duhet të forcohet puna për mirëmenaxhimin e vazhdueshëm të projekteve të investimeve publike, me qëllim rritjen e efektivitetit, efencës dhe ekonomicitetit në përdorimin e fondeve publike, në funksion të uljes së kostos dhe rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj taksapaguesve dhe qytetarëve.

Së katërti, rëndësi të veçantë ka zbatimi i një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme, shoqërive tregtare si dhe e çdo njësie që shpenzon fonde publike.

Së pesti, duhet të forcohet më tej puna e ministrive, institucioneve, njësive të vetqeverisjes vendore dhe enteve publike për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, me qëllim përmirësimin e procesit të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit, si dhe rritjen e efektivitetit në menaxhimin e fondeve publike.

Së gjashti, të gjitha institucionet buxhetore duhet të forcojnë punën për zbatimin korrekt të detyrimeve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore. Kjo kërkesë bëhet më e mprehtë në drejtim të zbatimit të legjislacionit fiskal dhe të prokurimit publik, si fusha me risk më të lartë.

Së shtati, duhet të rritet më tej bashkëpunimi midis Ministrisë së Financave, KLSH-së dhe Kuvendit për të bërë përmirësimet e nevojshme ligjore në fushën e buxhetit dhe të menaxhimit të financave publike.

Gjatë diskutimit shumica e anëtarëve të Komisionit mbështetën vlerësimet dhe argumentet e paraqitura nga relatorja, si dhe projektligjin në tërësi.

Deputetët e opozitës u shprehën kundër projektligjit.

V. Përfundim.

Mbështetur në argumentet e mësipërme, Komisioni e miratoi projektligjin “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2021” dhe raportit vjetor të konsoliduar të buxhetit, bashkëlidhur tij, me shumicë votash. Deputetët e opozitës votuan kundër projektligjit.

RELATORJA

Blerina GJYLAMETI

KRYETARI

Eduard SHALSI